

STATISTIKAT E TRANSPORTIT

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	6
8. Politika e botimit.....	7
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Menaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia.....	9
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Kohëria dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit
1.3. Personi i kontaktit	Adelina Velo
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialiste
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	avelo@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	27.10.2020
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	28.10.2019
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	27.10.2020
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat e Transportit përfshijnë informacion mbi flukset e mallrave dhe numrit të pasagjerëve sipas mënyrave të ndryshme të transportit, të tilla si: det, ajër dhe hekurudhë. Këto statistika përfshijnë: • Lëvizjen e numrit të pasagjerëve (ajër, det dhe hekurudhë) • Volumin e mallrave (ajër, det dhe hekurudhë) • Treguesit specifikë për transportin ajror • Vlera e Eksporteve /importeve e mallrave sipas transportit detar, hekurudhorë, rrugorë dhe ajror Statistikat e Transportit të prodhuara nga INSTAT nuk përfshijnë flukset e mallrave dhe pasagjerëve të transportit rrugor. Këto të dhëna nuk sigurohen nga burime administrative apo vrojtime të realizuara nga INSTAT.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Për klasifikimin e mallrave sipas mënyrave të ndryshme të transportit përdoret Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit i cili njihet shkurt si klasifikimi NST 2007. Ky klasifikim përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: me rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det. NST 2007 është plotësisht i ndërlidhur me Klasifikimin e Produkteve dhe

	Aktiviteve, CPA 2008 dhe Nomenklaturën e Aktiviteve Ekonomike (NVE Rev. 2). Rrjedhimisht, NST 2007 është gjithashtu në përputhje me klasifikimet homologe të Kombeve të Bashkuara (CPC dhe ISIC) dhe Nomenklaturën e Kombinuar (CN) 2007. Ky klasifikim mund të gjendet në linkun më poshtë: Nomenklatura Standarde e Mallrave për Statistikat e Transportit
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat për transportin detar, hekurudhor dhe ajror të kryer në Republikën e Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<u>Transport Rrugor</u> Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit rrugor. Inventari i mjeteve rrugore - Numri i mjeteve rrugore të regjistruara në datën e caktuar në një vend dhe të liçencuar për të përdorur rrugët me trafik publik. Kategoritë e rrugëve - Rrugët kategorizohen sipas tre llojeve kryesore të krahasueshme ndërkombëtarisht: Autostrada, Rrugë brenda zonave të banuara, Rrugë jashtë zonave të banuara dhe Rrugë të tjera. Autostradë - rrugët publike të destinuara për transportin në distanca të gjata të automjeteve motorike dhe janë pjesë e lidhjeve të autostradës me vendet fqinje. Kryqëzimet e veçanta për ngarje në autostradë dhe jashtë (të ashtuquajturat në rampat dhe rampat jashtë ose daljet) janë një pjesë e autostradave. Gjatësia e rrugës - Gjatësia e rrugës është distanca midis pikës fillestare dhe asaj fundore. Mjete transporti rrugor për pasagjerë - Quhen mjetet motorike të transportit rrugor të destinuara për transport pasagjerësh, në të cilën numri i vëndeve të uljes (duke përfshirë dhe shoferin) nuk e kalon numrin 9. Autobus - Quhet mjeti motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vëndeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9. Makina me qëllim të veçantë për pasagjerë – Vetura të pasagjerëve të dizajnuara për qëllime të ndryshme nga transporti i pasagjerëve. Kjo kategori përfshin p.sh. automjetet e zjarrfikësve, ambulancat, automjetet funeral, makina shkollore, automjetet garuese dhe automjetet e tjera të pasagjerëve që nuk specifikohen diku tjetër. Mjete rrugore për mallrat - Automjeti rrugor i projektuar, ekskluzivisht ose kryesisht, për të transportuar mallra. <u>Transport Hekurudhor</u> Çdo lëvizje e mallrave dhe / ose pasagjerëve që përdorin një automjet hekurudhor në një rrjet të caktuar hekurudhor. Gjatësia e shinave - Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit. Pasagjerë të transportuar me hekurudhë - Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përjashtuar personat e destinuar për shërbime në tren. Ton-kilometër (TKM) - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër. Mallra të transportuara me hekurudhë - Do të quhet çdo lëvizje malli që

kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë konteinerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

Tren-kilometër - janë distancat në kilometra të përshkuara nga trenat.

Transport Detar

Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Port statistikor - Një port statistikor përbëhet nga një ose më shumë porte, të kontrolluara normalisht nga një autoritet i vetëm porti, në gjendje të regjistrojë lëvizjet e anijeve dhe ngarkesave.

Porti i ngarkimit - Quhet porti ku mallrat ngarkohen në anije dhe transportohen prej saj.

Porti i shkarkimit - Quhet porti ku mallrat janë shkarkuar nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Transport ndërkombëtar detar - Quhet transporti detar mes dy porteve i lokalizuar në dy vënde të ndryshme.

Pasagjerë detar - Çdo person që bën një udhëtim në det në një anije tregtare.

Pasagjerë të embarkuar (të dalë) - Janë pasagjerë të cilët kanë hipur në anije dhe transportohen prej saj.

Pasagjerë të disembarkuar (të hyrë) - Janë pasagjerë të zbritur nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Pasagjerë/kilometër - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një pasagjeri në një anije tregtare mbi një kilometër.

TEU - Njësi statistikore e bazuar në kontenierët ISO me një lartësi 6.1 m (20 feet) për të siguruar një masë të standartizuar të kontenierëve me kapacitete të ndryshme dhe për përshkrimin e kapaciteteve të kontenierëve në anije. 6.1m (20 feet) = 1 TEU.

Transport Ajror

Çdo lëvizje e mallrave dhe / ose pasagjerëve në lëvizjen e avionëve.

Aeroport - Një zonë e caktuar e tokës ose ujit (përfshirë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet) të destinuara për t'u përdorur qoftë tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve dhe të hapur për operacionet tregtare të transportit ajror.

Linjë ajrore - Një ndërmarrje aviacioni që operon aeroplanët për qëllime tregtare që (i) kryen shërbime të planifikuara të transportit ajror, ose të dy, të cilat janë në dispozicion të publikut për transportin e pasagjerëve, postën, dhe / ose ngarkesa dhe (ii) është vërtetuar për qëllime të tilla nga autoriteti i aviacionit civil të shtetit në të cilin është themeluar.

Shërbimi ajror i pasagjerëve - Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar i kryer nga aeroplanët që transportojnë një ose më shumë pasagjerë të ardhura dhe çdo fluturim të listuar në oraret e publikuara si të hapura për pasagjerë.

Shërbimi ajror i mallrave dhe i postës - Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar, i kryer nga aeroplanët që mbajnë ngarkesa të ardhura (mallrave dhe postës), përveç pasagjerëve.

Numri i fluturimeve - Është numri i parë fillestar i publikuar i caktuar nga operatori i transportit ajror në fluturim. Pasagjerët që përdorin një fluturim nga një aeroplan mund të udhëtojnë nën një sërë numrash të ndryshëm fluturimesh.

Pasagjerë të transportuar - Do të quhen të gjithë pasagjerët udhëtimi i të cilëve fillon ose mbaron në aeroportin raportues.

Mallrat e transportuar - Përfshijnë çdo ngarkesë e ngarkuar në avion ose e shkarkuar prej tij, duke përfshirë bagazhet e pasagjerëve dhe postën.

	<u>Eksportet/importet e mallrave</u> Eksportet - Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv. Vlera F.O.B - Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues. Importet - Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor. Vlera C.I.F - Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.
3.5. Njësia statistikore	Njësitë statistikore sipas llojeve të transportit janë: • Hekurudha Shqiptare dhe ndërmarrjet private që operojnë në aktivitetin e Transportit Hekurudhorë • Portet detare për Transportin Detar • Aeroporti "Nënë Tereza" për të dhënat e transportit ajror • Ndërmarrjet eksportuese/importuese të cilat kryejnë aktivitet në transportin detar, hekurudhorë, rrugorë dhe ajror
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin numrin e pasagjerëve (shqiptarë dhe të huaj) si dhe volumin e mallrave.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e statistikave të transportit mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat e Transportit datojnë prej vitit 1993.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të dhënat mbi Statistikat e Transportit publikohen vetëm në vlera absolute dhe përqindje. Njësia matëse për pasagjerët është numri i pasagjerëve dhe pasagjerë për kilometër ndërsa për mallrat është ton dhe ton - km për ngarkim/shkarkimin e mallrave.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Statistikat e Transportit është mujore. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	➤ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e indikatorëve për statistikat e Transportit janë: • Ligjin Nr. 17/2018, “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2017-2021; ➤ Sipas rregulloreve përkatëse të BE-së janë: • Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 2018/643 “Mbi Statistikat e Transportit” • Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 2009/42, datë 6 Maj

	2009 “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave dhe udhëtarëve nga deti” • Rregullorja e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 2018/974, datë 4 Qershor 2018 “Mbi Statistikat e Transportit të mallrave përmes rrugëve ujore brenda vendit” • Rregullorja e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 70/2012, datë 18 Janar 2012 “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin e mallrave me rrugë” • Rregullorja e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr. 437/2003, datë 27 Shkurt 2003 “Mbi kthimet statistikore në lidhje me transportin ajror të udhëtarëve, mallrave dhe postës”
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Transportit nuk transmetohen në EUROSTAT.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur;

	kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore. Të dhënat e publikuara janë në nivel të agreguar, të dhënat individuale nuk janë të publikuara.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit, në fund të vitit paraardhës. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34, të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit mujor të Statistikave të Transportit janë si më poshtë: 1. Website – Njoftimi për Shtyp dhe databaza statistikore 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose e-mail); 3. Publikimi “Statistikat e Transportit” 4. Pjesa e dedikuar për të kontaktuar INSTAT
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Statistikat e Transportit shpërndahen në baza mujore dhe vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të statistikave të transportit: • Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte. • Volumi i mallrave të transportuar (me ajër dhe hekurudhë). • Numri i pasagjerëve që udhëtojnë (me ajër, det dhe hekurudhë). • Treguesit specifikë të transportit ajror. • Treguesit e vlerës së eksporteve/importeve të mallrave (me det, hekurudhorë, rrugë dhe ajër) Njoftimi për shtyp publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Statistikat e Transportit gjenden të botuara në botimin “Vjetarin Statistikor”, në “Vjetarin Statistikor Rajonal” dhe në botimin “Shqipëria në Shifra”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:

	• Statistikat e Transportit • Vjetari Statistikor • Vjetari Statistikor Rajonal • Shqipëria në Shifra
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhëna më të detajuara janë të publikuara në faqen web të INSTAT: Databaza statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesiioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash formulari .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT mbi Statistikat e Transportit, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve për llojet e ndryshme të transportit. Në faqen e INSTAT, ndodhet një seksion lidhur me metodogjinë e përdorur mbi Statistikat e Transportit, i cili mund të gjendet në link-un: Metodologji Transporti .
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ndjekura lidhur me Statistikat e Transportit për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin Nr.17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT, për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e transportit krahasohen me të dhënat e transportit një vit më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.

12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave të transportit janë si më poshtë: • Institucione të administratës publike • Universitete • Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Biznese • Kërkues shkencorë, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme. Treguesit e Statistikave të Transportit dërgohen çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish. Disa tregues kryesorë dërgohen nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të ndryshëm në: Eurostat, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Federata Ndërkombëtare e Rrugëve (IRF), Forumi Ndërkombëtar i Transportit (ITF), etj.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	Page Views (Klikime) në lidhje me Statistikat e Transportit për vitin 2019 janë rreth 15,994 klikime. INSTAT, ka kryer vërtetimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të statistikave për fushën e Transportit?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3.54 (70.8%) INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave të Transportit për vitin 2020 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT nga ato të kërkuara nga rregulloret e ndjekura. Nuk sigurohet informacion për transportin rrugor të mallrave apo pasagjerëve si dhe treguesit e mjeteve rrugore sipas karakteristikave të tyre.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Të dhënat mbi transportin hekurudhorë, detar dhe ajror mblidhen në mënyrë administrative në zbatim të bazës ligjore dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit. Nuk kryhen vërtetime për të dhënat e transportit.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo-kampionimit trajtohen bazuar në politikën e Trajtimit të Gabimeve. Për më shumë, referohuni: Politika e Trajtimit të Gabimeve.

14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore

Rezultatet e Statistikave të Transportit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 301 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+301ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Transportit është 31 Dhjetori 2019.

Periudha referuese	12/31/2019
Data e publikimit	10/27/2020
Afatet kohore	301

14.2. Përpikmëria

Të dhënat për Statistikat e Transportit publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Transportit ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.

Periudha referuese	12/31/2019
Data e shpallur	10/27/2020
Data e publikimit	10/27/2020
Vonesa në kohë	0

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike

Të dhënat që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e EUROSTAT.
Statistikat e Transportit prodhohen në nivel vendi dhe sipas qarqeve.

15.2. Krahasueshmëria kohore

Informacioni statistikor grumbullohet në mënyrë tremujore duke filluar nga viti 1993 deri në 2016. Nga viti 2016 e në vazhdim, të dhënat publikohen çdo muaj, duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 5 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=5).

15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave

Nuk aplikohet.

15.4. Koherenca e brendshme

Përpara finalizimit të të dhënave, kontrollohet konsistenca e brendshme e tyre. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca e tyre në seri të ndryshme.

16. Kostoja dhe ngarkesa

Stafi i dedikuar për Statistikat e Transportit është 1 punonjës.

17. Rishikimi i të dhënave

17.1. Politika e rishikimit

Politikat e rishikimit të statistikave të transportit hartohen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë, referohuni:

- [Politika e Revizionimit Statistikor](#)
- [Politika e Trajtimit të Gabimeve](#)

17.2. Praktika e rishikimit

Në rast se autoritetet lokale do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara pranë INSTAT, informacioni përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.

18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i vetëm i të dhënave të transportit është burimi administrativ. Të dhënat grumbullohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Mbulimi është në nivel vendi, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo muaj.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e transportit janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor grumbullohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënat për transportin u kryhen kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole realizohen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	